

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE
“Artemis Energy” sh.p.k

Tiranë më datë 16/05/2018.

NENI 1

Shoqëria Tregtare “Artemis Energy” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në baze të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

NENI 2. Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “Artemis Energy” sh.p.k

NENI 3. Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive në fushën e energjisë. Konkretisht:

1. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë;
2. Prodhimi i gazit; shpërndarja e lëndëve të gazta nëpërmjet tubacioneve;
3. Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve për prodhimin energjisë dhe infrastruktura e impianteve. Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë;
4. Asistenca teknike, riparime dhe mirembajta e aparaturave për prodhimin e energjisë. Import - eksporti, tregtimi me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave që lidhen me kryerjen e aktivitetit në fushën e energjisë;
5. Instalimi dhe ndërtimi i impianteve energjitike nga burime të rinovueshme nga dielli, era, uji, etj;
6. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë nga burime të rinovueshme;
7. Importi dhe eksporti i mallrave e paisjeve të teknologjisë në fushën energjitikës, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen, dhe menaxhimin e centraleve me impjante fotovoltaike e forma të tjera të prodhimit të energjisë të ushqyera nga burime të ndryshme dhe nga ato të caktuara si: hidroelektrike, diellore, me erë, biomasa etj;
8. Mirëmbajtje të centraleve energjitike;
9. Zhvillim të projekteve në sektorin e energjive të rinovueshme, ndërtim dhe mirëmbajtje të punimeve civile, objekteve të ndryshme, linjave elektrike, kërkim dhe zhvillim të shpellave dhe minierave.

NENI 4. Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Murat Toptani”, Gjergji Center, Kati 6-te, Tiranë, Shqiperi.



NENI 5. Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100.000 lekë. Kapitali ndahet në një (1) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

z. Samuele Margheriti, i lindur më 20/10/1966, në Romano di Lombardia, Itali, shtetas italian, banues ne Tanzi Montebello nr. 41/A, Itali, idenfitikuar nëpërmjet kartës së identitetit me nr. AS 6336953, në cilësinë e ortaku themelues zotëron 100 % të vlerës së kapitalit themeltar i nënshkruar, i barabartë me 1 kuotë me vlerë 100.000 ALL.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

NENI 6. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7. Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është **z. Samuele Margheriti**, i lindur më 20/10/1966, në Romano di Lombardia, Itali, shtetas italian, banues ne Tanzi Montebello nr. 41/A, Itali, idenfitikuar nëpërmjet kartës së identitetit me nr. AS 6336953, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5(pesë) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi


NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël. Shoqëria do të hapë pranë Bankës Credins ne Rr. Gjin Bue Shpata, pranë Stadiumit “Selman Stermasi”, Tiranë llogaritë e shoqërisë në cilësinë e shoqërisë në regjistrim e sipër.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10



Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

NENI 13. Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe 3 (tre) kopje në gjuhën angleze, ku prevalon ai në gjuhën shqipe.

Ortaku

SAMUELLI MARGONATI



Administratori

SAMUELLI MARGONATI

